

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Krime të Rënda—në trupin gjykues të përberë nga gjyqtari Vehbi Kashtanjeva- kryetar i trupit gjykues-gjyqtarët Nora Bllaca dhe Hamdi Ibrahim, si anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Ferinaze Jashari, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.B., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par. 1, të KPPK-së, sipas aktakuzës së ish Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë PP.nr. 572-3/2008, të datës 18.08.2008, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë verbal e publik në prezencë të prokurores së shtetit Bukurije Gjonbalaj, të akuzuarit A.B., mbrojtësit të tij av. M. H., me datë 25.04.2017, publikisht mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.B., i biri i I. dhe i nënës Z., i vajzërisë B., i lindur me datë *data e lindjes...*, në fshatin L., Komuna e P., ku edhe jeton, ka kryer katër vjet shkollë, i gjendjes së dobët ekonomike, pensionist, i martuar, baba i 9 fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal *numër personal...*

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 17.08.2008, në orën 18:35, minuta, në P., në rrugën ‘Skenderbeu’, të pandehurit gjatë një kontrolli nga ana e pjesëtareve të Policisë së Kosovës, i është gjetur dhe konfiskuar revolva e tipit ‘TT’, e kalibrit 7.62mm, me numër serik I-225437, me të cilin gjatë një ahengu familjar – dasmës, në shenjë gëzimi ka shtën në ajër disa herë, të cilën e mbante pa autorizim.

-Me çka ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par. 1, të KPPK-së

Andaj gjykata në kuptim të neneve 2,3,4,41,42,49,50,51,69,73,75,76, 374 të KPRK-së dhe nenit 359, 365, 450 të KPPRK-së e :

GJYKON

MË DËNIM ME BURGIM-DËNIM ME KUSHT në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në afat prej **1 (një) viti** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari A.B., në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej nga **30 (njëzet) euro**, në afat prej **15 ditësh** nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

DËNIMIN PLOTËSUES-Të akuzuarit A.B., i konfiskohet revolja e tipit ‘TT’, e kalibrit 7.62mm, me numër serik I-225437.

A r s y e t i m

Ish Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë, ka ngritur aktakuzën PP.nr.572-3/2008, të datës 18.08.2008, kundër të akuzuarit A.B., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par. 1, të KPPK-së

Gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësor me datën 25.04.2017, në të cilën prokurorja e shtetit Bukurije Gjonbalaj, ka bërë leximin e aktakuzës kundër të akuzuarit A.B., i cili pasi që është njoftuar me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 të KPPK-së, i njëjti ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën, nuk ka nevojë për shënim shtesë dhe pasi që i ipet mundësia që të pranoj, ose mos e pranoj fajësinë lidhur me veprën penale që i vihet në barrë, i njëjti deklaroi se e pranoi fajësinë për veprën penale si në aktakuzë.

Prokurorja e shtetit Bukurije Gjonbalaj, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit A.B., për veprën penale e cila i bie në barrë, duke propozuar që gjykata të njëjtin të shpall fajtorë dhe t’i dënoj sipas ligjit. Me pranimin e fajësisë pajtohet edhe mbrojtësi i të akuzuarit av. M. H..

Gjykata e aprovoj pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kushtet nga neni 326 par. 1 i KPPK-së, se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare pas konsultave të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, i cili pranim mbështetët në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza, në materialin e prezantuar nga prokurorja e shtetit, të pranuar nga i akuzuari.

Prokurorja e shtetit Bukurije Gjonbalaj, në fjalën përfundimtare ka theksuar se është vërtetua gjendja faktike se i pandehuri A.B., e ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par. 1, të KPPK-së, i cili pranim është në përputhshmëri me provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës. Në fund i ka propozuar gjykatës, që të pandehurin ta shpall fajtor ta dënoj sipas ligjit dhe gjatë matjes së dënimit të merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe si rrethanë lehtësuese të merret fakti se i pandehuri ka pranuar fajësinë gjatë seancës gjyqësore.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. M. H., ne fjalën përfundimtare ka theksuar se i mbrojturi i tij e ka pranuar fajësinë, është penduar thell për kryerjen veprës penale dhe kjo është hera e parë që ai bie ne ndesh me ligjin, duke i propozuar gjykatës që me rastin e matjes dhe shqiptimit të sanksionit penal të merr për bazë si rrethanë lehtësuese edhe faktin se është i gjendjes se dobët ekonomike, mbajtës i familjes dhe pensioner. Duke i propozuar gjykatës që gjatë matjes së dënimit te ketë parasysh edhe dispozitat për zbutjen e dënimit.

I akuzuari A.B., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e përkrah fjalën përfundimtare të mbrojtësit, duke premtuar se të ardhmen nuk do të kryej vepra penale dhe është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale.

Me rastin e përcaktimit të dënimit Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit mori parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, sjelljet e mira gjatë seancës gjyqësore dhe pendimin e thellë të shprehur gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe faktin se i njëjti është mbajtës i familjes. Për të akuzuarin gjykata nuk gjeti rrethana rënduese.

Gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe me aplikimin e dispozitave ligjore konform nenit 75 dhe 76 të KPRK-së, me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës dhe përgjegjësisë penale dhe i njëjti do të shërbejë si preventivë individuale dhe gjeneralë dhe parandalim se në të ardhmen nuk do të kryen vepra penale, duke ndikuar në rehabilitimin e tij, me denimi e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit sikurse që parashihet me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimin për konfiskimin e armës, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 69 të KPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata i mori në bazë të nenit 450 par.3 të KPRK-së.

Nga sa u tha me lartë u vendos sikur ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr. 502/08, të datës 25.04.2017**

**Procesmbajtësja:
Ferinaze Jashari**

**Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari:
Vehbi Kashtanjeva**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.